

REXHEP QOSJA  
**TË FSHEHTAT E TREGUARA**  
ROMAN

---

BOTIMET TOENA



REXHEP QOSJA

**TË FSHEHTAT E TREGUARA**

*Roman omnibus  
me dokumente reale dhe imagjinare*

BOTIMET TOENA  
Tiranë, 2020

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-95-4

© Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

Përpos personazheve imagjinare, që janë më të shumta, në këtë roman omnibus paraqiten edhe personazhe reale, me nofka, emra e mbiemra të vërtetë ose të ndryshuar, që janë të paktë. Sjelljet, veprimet, mendimet e tyre të mira apo të këqija, paqësore apo të dhunshme, të dëshirueshme apo të frikshme janë të imagjinuara e jo vërtet të ndodhura. Në qoftë se ndonjërit prej tyre i pëlqen shumë apo e tranon vetja në roman, kjo s'është as meritë e as faj i shkrintarit po i vetë personazhit.

Nuk mund t'i shërbehet edhe Zotit edhe Mamonit.  
*Ungjilli*

Shpirti është i fshehur në trup e ti je i fshehur në shpirt,  
O ti, që je i fshehur në atë që është e fshehur  
Ti je më shumë se të gjitha.  
*Rumiu*

Njeriu është Zot kur ëndërron, por vetëm varfanjak kur  
mendon.  
*Helderlin*

Edhe po të mos bënte çka ka menduar, moçalin tonë do  
ta trazonte.  
*Gynter Gras*

Gjenialiteti është kapacitet i madh për t'i duruar të  
gjitha, - tha Kue.  
Përpos të padurueshmes, - thashë unë.  
*Gilermo Cabrera Infante*

Të lumtë ata që jetojnë dhe flenë në histori.  
*Hulio Kortasar*

**KUSH SOT E KUSH NESËR**





## PSE PO E SHKRUAJ KËTË ROMAN?

Posa ulem në karrige, afër tryezës së punës, në të cilën i kam shkruar pothuaj të gjithë ata libra që kam shkruar deri sot, e, mjerisht, janë më shumë se ç’do të ishte mirë për mua, m’u bë se tryeza disi e mpakur nisi të largohet prej meje.

Hej! Hej, ku do? E pyes, por ajo nuk më përgjigjet.

Je në vete apo je çmendur në këtë vapë të madhe? E pyes prapë duke mos menduar se me këtë pyetje mund ta hidhëroj, por ajo as në këtë pyetje nuk më përgjigjet.

Në vend që ta bezdis më tej me pyetje, duke pritur po-të e jo-të, u turra pas saj, natyrisht i ulur në karrige, derisa ajo, tryeza e punës, nuk u ndal te muri, në anën e djathtë të dritares.

Këtu e kam vendin unë e jo atje në mes të dhomës, tha. Tani unë po të pyes ty se kush më ka qitur atje dhe më ka qitur atje, në mes të dhomës, pa më pyetur?

Nuk dita t’i përgjigjem se kush e kishte hequr tryezën e punës prej vendit ku kishte qenë gjatë pesëdhjetë e pesë vjetëve dhe e kishte vënë në mes të dhomës, thuajse tani e tutje nuk do të shkruhej më në të, por do të luhej bixhoz!

Ndjeva një siklet, plot gëlimmendor që ma kishte sjellë në mendje atë shkrimtarin e mendimtarin e Italisë, Umberton, Umberto Ekon, i cili thotë se kishte ndier njëfarë sikleti kur ishte ulur të shkruante romanin e tij, nuk e di a ishte i fundit a i parafundit, *Varreza e Pragës*.

Dhe, i sigurt, prej këtij sikleti, më doli gjumi.

Ndoshta më shpejtueshëm se mëngjeseve të tjera bëra çka mendova se duhej bërë për ta marrë veten.

Vërej: asnjë send në dhomë nuk lëviz, as ato sende që janë në dysheme, as ato që janë në mure e në dritare e as ato, të paktat, që janë ngjitur në tavan.

Dëgjoj: ushtima e veturave dhe automjeteve të tjera në rrugën, që s'është larg shtëpisë sime, është e njëjtë dhe i njëjtë është edhe zëri i papagallit në kafazin e tij në paradhomë.

Prek: prek njëherë me dorën e djathtë e, mandej, edhe me të majtën, sendet që kam afër e, mandej, kur çohem në këmbë, edhe sendet e tjera nëpër dhomë: edhe sendet janë të qeta, edhe duart e mia janë të dëgjueshme!

E, mandej, ndoshta më ngadalë se mëngjeseve të tjera, bëj çka duhet të bëhet për ta quajtur veten të përgatitur trupërisht dhe shpirtërisht për t'u ulur në karrigen në të cilën gjatë pesëdhjetë e pesë vjetëve jam ulur pranë kësaj tryeze, që është ku kishte qenë gjithnjë: e mbështetur për muri në anën e djathtë të dritares së djathtë të dhomës, që quhet e imja.

Dhe, në karrigen pesëdhjetepesëvjeçare ulem pa u liruar prej sikletit që më ka shkaktuar ëndrra e rrëfyer, ndoshta jo me të gjitha cikërrimat që përmban ajo, që, mendoj, nuk do të duhej t'ia tregoja lexuesit.

Vë bërrylat në tryezë, i afroj letrat e bashkuara me një kapëse të bardhë, i afroj tre lapskimikët e trashësive të ndryshme me të cilët shkruaj - jo gjithnjë, duke i ndërruar pas çdo dy a tri orësh dhe nuk lë pa e afruar edhe celularin të cilit pa harruar ia shurdhoj zërin, kur të fortë e kur të squllët.

Marr lapskimikun e kaltër dhe ia afroj fletës së bardhë dhe shkruaj fjalën e parë të romanit *Ajo*, por shpejt i bie vijë dhe shkruaj emrin *Havaja*.

Por, ndiej: sikleti nuk më ka kaluar.

Uni im i parë pyet Unin tim të dytë: përse nuk të kaloi ai siklet?

Por, Uni i dytë, ndoshta pse është i dytë, nuk i përgjigjet Unit tim të parë. Dhe, nuk i përgjigjet ndoshta bash pse është Unë i dytë e Uni i dytë, si të gjithë unët e dytë, dëshirojnë t'i mistifikojnë përgjigjet që duhet t'u jepen pyetjeve të unëve të parë.

Megjithëse i kam lexuar shumicën e veprave të Umbertos, të Umberto Ekos, jo vetëm ato letrare, por edhe ato teorike e estetike, nuk mund të them se i kam të qarta arsyet e sikletit që i shfaqej kur ulej të shkruante romanin *Varreza e Pragës*, e, ndoshta, jo vetëm kur ulej të shkruante këtë roman të madh me sasi e me cilësi, por edhe kur ulej të shkruante edhe veprat e tjera, sidomos romanet e tjera. Mesjeta, prej së cilës vijjnë pothuaj të gjitha temat e motivet e romaneve të tij, janë përplot jezuitë, masonë, satanistë, satanistë historikë, karbonarë, maxinianë, thika, kama, sakica të ndryshkura, të vdekur që ngjallen, të gjallë që vdesin pa vdekur, kryqtarë e të tjerë të ngjashëm e të pangjashëm, që mund t'i kenë shkaktuar siklete të ndryshme më të shkurtra e më të gjata Atij, Umbertos.

Por, rrefimtari i romanit me protagonistë Bardhin e Havanë mund të ketë edhe disa arsye të tjera pse sikletoset, që nuk i ka pasur shkrimtari i Italisë. Për dallim prej italianit, për mua të përveçuar, që nuk frikësohet se mund të dalë dikush e të kërkojë prej tij të shkruajë kështu e të

mos shkruajë ashtu, rrëfimtari, që po rrëfen i privilegjuar si autor i romanit që do të lexoni, mund ta marrë me mend se krejt kush, i madh e i vogël, i fuqishëm e i lig, do t'i thotë të shkruajë kështu e të mos shkruajë ashtu, të shkruajë këtë e të mos e shkruajë atë, të shkruajë për njërin çka i thuhet e të mos shkruajë për tjetrin çka ai do pra, pra, ta përsëris mendimin: të shkruajë për njëren çka i thuhet e të mos shkruajë për tjetrin çka ai do.

Do, do, do! S'do, s'do, s'do!

I mbyll dhe i çel sytë nëntë herë me shpresë se sado pak do të lirohem prej sikletit, që mund të më kallë krupën, që më ishte shfaqur pas ëndrrës që kisha parë mbrëmë s'e dija ende mirë, saktë, në orën sa pas mesnatës. Ngre kryet përpjetë kur symbyllur e kur syçelur; ul kryet teposhtë kur symbyllur e kur syçelur duke kujtuar Budën, Jezuin dhe Muhametin mos ata me engjëjt a djajtë që urdhërojnë do të më lirojnë prej sikletit, por, kot: sikleti po ma sundon shpirtin. Krupa po më zë frymën!

Nuk e di pas sa kohe qërimhesapësh të brendshme me vetveten, në mbamendjen time shfaqet zgjidhja e shprehur me këtë fjali: ke vendosur të shkruash për Një siklet të madh shpirtëror dhe për Do siklete shoqërore, prandaj, nuk e di pse ke harruar se më mirë shkruhet kur ke siklet sesa kur je i gëzuar.

Fillo të shkruash! Rrëfe për veten fare pak dhe rrëfe për të tjerët, shumë, për disa shumë të njohur, disa më pak e disa aspak të njohur ende. Mos u sikleto nëse do t'i bëjë të njohur apo të çnjohur rrëfimi yt dhe rrëfimi mbizotërues i protagonistit tënd.

Dy rrëfimet e romanit dhe rrëfimtari e dy protagonistët do të kujtohen e ata do të harrohen.

Siç janë harruar kryetarët e kryeministrat dhe kryetarët e kuvendeve të Francës, të Britanisë së Madhe e të Gjermanisë në shekullin XIX, ndërsa do të kujtohen e adhurohen gjatë e gjatë Floberi e Balzaku, Bajroni e Skoti, Gëte e Shileri.

Fillo të shkruash! Trego për të fshehtat!

Të fshehtat e rëndësishme e të parëndësishme, pikëlluese e argëtuese, të përhershme e kalimtare, vendore e botërore. Të fshehtat që, si të gjitha të ndodhurat e të bërat duhet të jenë të treguara. Të fshehtat me të cilat kjo Botë jeton hanedan.

Të mos ju flas për veten: unë jam rrëfimtari, e rrëfimtari duhet të jetë sa më i padukshëm në roman, por t'ia jap fjalën protagonistit, shpesh dhe protagonistes e personazheve që ua bëjnë frymëmarrjen të lehtë, të tjerëve që ua bëjnë të ofshamat dhe, pse jo, edhe atyre asnjansëve që s'u sjellin as gëzim as hidhërim.

## DIALOGU 1: EDHE SYTË MASHTROJNË

BARDHI

A je mirë, Hava?

HAVAJA

Mirë jam, mirë, pse po pyet?

BARDHI

Po ecën lodhshëm.

HAVAJA

Po eci si edhe ditëve të tjera.

BARDHI

Ditëve të tjera nuk kemi ecur kaq larg sa sot.

HAVAJA

Ecja gjatë ndoshta më ka lodhur pak sot.

BARDHI

Ecja gjatë e forcon trupin.

HAVAJA

Dhe, shpirtin.

BARDHI

Mos po të vret këpuca në këmbën e djathtë?

HAVAJA

Jo, jo nuk po më vret; e ka numrin e njëjtë me këpucët që kam mbajtur gjithnjë.

BARDHI

Kam përshtypjen se këmbën e djathtë je duke e lëvizur më ngadalë, më lodhshëm se të majtën.

HAVAJA  
Mua nuk po më duket ashtu.  
BARDHI  
A të pushojmë pak këtu e mandej kthehemi në shtëpi?  
HAVAJA  
Nuk më pëlqen të pushojmë këtu!  
BARDHI  
Pse?  
HAVAJA  
E ka emrin trishtues kjo kodër këtu!  
BARDHI  
E si e ka emrin?  
HAVAJA  
Shkëmbi i Kalasë.  
BARDHI  
Çka ka të keqe në këtë emër, në këtë Kala?  
HAVAJA  
Është e rrethuar me varre kjo Kala, ka herë e  
padukshme, e rrafshuar me tokën.  
BARDHI  
Ani, pushojmë duke u kthyer te Kroi i Cubit. Dhe, pimë  
uji kroi.  
HAVAJA  
As emri i këtij kroi nuk më pëlqen!  
BARDHI  
Po pse nuk të pëlqen, Hava?  
HAVAJA  
Cubat s'bëjnë kroje, po vjedhin, më thoshte babai.  
BARDHI  
Ani pushojmë ku të duash ti.

HAVAJA

Unë dua të pushojmë kur të mbërrijmë në shtëpi.

BARDHI

Fjala e Havasë fjala e të MADHIT për mua.

HAVAJA

Me shaka, Bardh, gjithmonë më gëzon. E më mëkon me qeshjen tënde artistike si unë dikur Anilën e Likun me qumështin e gjinjve të mi.



## KUSH JAM DHE KUSH DO TË JEM

Jam i vetëdijshëm se lexuesit dëshirojnë të dinë në mos jo çdo gjë, së paku sa më shumë, për protagonistët kryesorë të romaneve që marrin të lexojnë. Me dëshirë që të kënaq deri diku këtë interesim të arsyeshëm të lexuesve të romanit, të cilit ende s'ia di titullin, për kryeprotagonistin e tij po sjell këtu, menjëherë në fillim të rrëfimit, disa të dhëna për të, të shkruara me dorën e tij, disa prej tyre e të mbledhura prej rrëfimitarit në gazeta e në revista, në televizione e në radio, në spital e në sigurimet shtetërore disa të tjera.

Unë, kryeprotagonisti i romanit të patitull quhem Bardh Dynjaja.

Jetoj në qytetin kryeqytet i Kosovës.

Jam i martuar me Hava Gjylametin.

Kemi dy fëmijë, vajzë e djalë. Anilën dhe Likun.

Sot, kur po i qes këtu këto të dhëna, kam mbushur boll vjet, s'po ju them sa.

Për mua, nuk mund të mos e them, më e rëndësishme se ku jetoj është ku kam lindur. Dhe, është më e rëndësishme jo pse jam i lumtur që kam lindur ku kam lindur, por pse të kaluarën e vendlindjes sime nuk mund ta largoj asnjë çast prej kujtesës sime; në të vërtetë vendlindja është barra që gjithmonë e gjithkund, ditë e natë, dimër e verë, e mbaj në shpinë e në shpirt!

Kam lindur në fshatin F. Në Kosovë.

Gjatë Luftës së Dytë Ballkanike fshati F. ishte njëri prej dyzet e nëntë fshatrave shqiptare të Kosovës, që ushtria serbe dhe ushtria malazeze i kishin djegur plotësisht duke vrarë të gjithë meshkujt e tyre të mëdhenj e të vegjël, që kishin mbërritur t'i shtinin në duar? Gjyshi im, Shok Dynjaja, ishte prej të paktëve që kishte ikur me kohë me të shoqen, me nënën e me të birin e vetëm, babanë tim të ardhshëm. Do të mbërrinjë, për fatin e tyre dhe të tjerëve që kishin mbetur gjallë pas masakrës serbo malazeze, në Siri, më falni, në Shkodër, në Shkodrën tonë të dashur ku do të jetojnë deri në fund të Luftës së Parë Botërore.

Në fshatin F., që ka gjithsej gjashtëdhjetë e shtatë shtëpi, të ngritura pas Luftës së Dytë Botërore, dhe vetëm nëntë themele të ruajtura si dëshmi historike të shtëpive të djegura, do të kryej shkollën fillore, kurse tetëvjeçaren, shkollën e mesme dhe Fakultetin e Filologjisë do t'i kryej në kryeqytet. Në Fakultetin e Filologjisë do të studioj Gjuhën dhe Letërsinë Franceze si lëndë të parë dhe Gjuhën e Letërsinë Angleze si lëndë të dytë. Pas diplomimit do të më bëhet i mundshëm specializimi në Francë, në qytetin Lion.

Qe rreth tre muaj jam i pranuar në punë në Arkivin Qendror të Kosovës si përkthyes, kurse në dokumentin e punësimit shkruan përkthyes arkivist. Nuk mund të mos e them se unë, vetë, ndihem më i lumtur - si përkthyes sesa si përkthyes arkivist. Arsyet e kësaj ndjenje që kam nuk po i tregoj me shpresë se lexuesi do t'i kuptojë gjatë leximit të romanit.

Ditën kur i kam çuar dokumentet për punë në Arkiv dhe ditën kur më është dorëzuar dokumenti i pranimit në punë si përkthyes arkivist, më është thënë se detyrat e mia aty

do të jenë të ndryshme, qoftë si detyra të përkthyesit, qoftë si detyra të arkivistit. Do të hulumtoj çka do të kërkohet të hulumtoj; do të përkthej çka do të dëshiroj, por shumë më tepër çka do të kërkohet prej drejtuesve të Arkivit që të përkthej prej gjuhëve të huaja që di, në gjuhën shqipe dhe prej gjuhës shqipe në ato gjuhë të huaja! Dhe, këto fjalë që m'u thanë ditën kur i paraqita dokumentet për punësim aty dhe këto fjalë që m'u thanë ditën kur m'u dha dokumenti se jam pranuar në punë aty, më bëjnë të mendoj se unë e di kush jam, por tani për tani nuk mund ta di se kush do të jem!

Bardh Dunjaja, dora vetë.  
Në Arkivin Qendror të Kosovës.

Bardh Dynjaja është përkthyes i brezit të mesëm të përkthyesve tanë. Konsiderohet si njëri prej njohësve më të mirë të gjuhës e të letërsisë franceze në Kosovë, specializuar gjatë dy vjetëve në Francë, si bursist i Ministrisë sonë për Arsim, Shkencë e Teknologji. Deri tash ka përkthyer një varg veprash të letërsisë franceze, kryesisht në prozë, por edhe dy romane nga letërsia amerikane: njëri roman i Ernest Hemingueit e tjetri roman i Uiliem Foknerit. Ai çmohet përkthyes më i guximshëm se të tjerët, më drejt të thuhet se disa të tjerë, për shkak se i hyn përkthimit edhe të veprave të disa autorëve shumë të vështirë për përkthim, siç është, për shembull, nobelisti i njohur Fokneri. Po një përkthim i tij është konsideruar i paqartë, i ngatërruar, i pakuptueshëm, prandaj edhe nuk ka fituar pëlqimin e recensuesve për botim jo vetëm në shtëpinë botuese *Zodiaku*, por në asnjë shtëpi tjetër botuese serioze në Kosovë. Këto përkthime do t'i botojë një shtëpi botuese, që i është përkushtuar përkthimit

dhe botimit të disa veprave avangarde, pavarësisht sa të pakuptueshme janë ato!

*Gazeta Zodiaku i Shtëpisë*  
Botues *Zodiaku*, nr. 9, 9 mars 2016

Më shpesh se përkthyesit e tjerë, Bardh Dynjaja shihet në Zagreb, në Romë, në Stamboll, në Londër, por më së shpeshti në Paris.

Ka qejf të thotë se prej andej sjell botën në kulturën dhe në letërsinë tonë.

Të tjerët thonë se më e rëndësishme se të mësojmë çka sjell prej andej është të mësojmë se çka çon atje.

E atje, thonë, çon vetëm përkthimet e veta. Dhe, mendimet e veprimet e të tjerëve.

Ende nuk dihet cilët kanë më shumë të drejtë: ata që tregojnë çka çon apo ata që tregojnë se çka sjell.

Deklaratë e përsëritur e gazetarit Gani Qameti dhe e botuar në të përjavshmen,

*Satirikoni*, nr. 117, 5 prill 2016

## JU PËRSHËNDES TË GJITHË JU

Vëllezër e motra,  
miq e dashamirë,  
shokë e shoqe,  
zonja e zotërinj,  
shkëlqesi dhe shkëlqessha,  
lartmadhëri dhe lartmadhëresha!

Ju përshëndes ju të gjithë që jeni këtu, në këtë sallë të madhe, të gjatë e të gjerë, me tavan të lartë, të gjithë këtu në rreshtin e parë e deri në rreshtin e fundit, të fundit si rresht e jo të fundit në ndonjë mënyrë tjetër, në ndonjë mënyrë tjerët që dikush e quan politike, dikush shtetërore, dikush shoqërore, dikush shkollore, dikush mendore, dikush zakonore, dikush kanunore e dikush morale!

Më falni, harrova t'ju them e duhej t'jua thosha në fillim, se kjo nuk është fjalë e imja, kjo fjalë është e shkëlqesisë sonë, e shkruar anglisht për mysafirët, numri i të cilëve këtu është i madh, kurse unë jam vetëm përkthyes i saj, i kësaj fjale.

Unë, që jam i zgjedhur prej jush, në të vërtetë, i zgjedhur prej shkëlqesive e lartmadhërive tona, ju përshëndes të gjithë pa kurrfarë dallimi a dallimesh në të gjithë njëzet e nëntë rreshtat e numëruar, por megjithatë, megjithatë, pra, rendi e do që disa prej juve, populli këtu do të thoshte disa prej jush, do t'i përshëndes në mënyrë të veçantë duke jua

përmendur emrat, duke i përmendur emrat e tyre të nderuar, sepse edhe ju i përmendni shumë shpesh çdo ditë, shumë shpesh edhe çdo natë, shumë shpesh në çdo stinë të vitit, pavarësisht çfarë kohe është, e kthjellët a e vranët, me shi a me borë, me erë a e qetë. Dhe këtë përshëndetje të veçantë e përcaktojnë puna që bën kush, përgjegjësia shoqërore, politike e shtetërore që ka kush, mandej mosha që ka kush, përmendorja që i është ngritur kujt, që i është ngritur apo që do t'i ngrihet kujt në qytetin tonë, në shtetin tonë, në arkivin tonë, më falni, në arkivat tanë, se ky këtu nuk është i vetmi arkiv yni megjithëse është kryesori, më i madhi, më i pasuri me lëndë arkivore, shoqërore, kulturore, politike, shtetërore, të përgjithshme e të veçantë, historike, po historike.

Për këtë arsye kam kënaqësi të veçantë, të rrallë, që s'më dhurohet shpesh, të përshëndes të parin e të gjithë të parëve, të kryesorëve tanë politikë e shtetërorë, lartmadhërinë e tij, shkëlqesinë e tij.

Tahir Temanin.

Të përshëndes, të përveçuarin, të parin e ministrive, të njëzet e tri ministrive të tij të rëndësishme, shumë të rëndësishme, shkëlqesinë dhe lartmadhërinë e tij, Bali Bollëkun.

Të përshëndes zëvendësit e tij, të nëntë zëvendësit e tij e tanë të dashur, të parin, të dytin, të tretin, të katërtin, të pestin, të gjashtin, të shtatin, të tetin dhe të nëntin, të cilëve në këtë mënyrë, duke i numëruar, ua lashë edhe emrat e mbiemrat e pashqiptuar me këtë rast.

Të përshëndes ministrat, njëzet e tre ministrat dhe njëqind e njëzet e tre zëvendësit e tyre, të cilëve nuk po ua them emrat i ndërgjegjshëm se ju, që po më shikoni e po më dëgjoni me vëmendje të veçantë, për çka ju falënderoj

shumë, shumë, të gjithëve, ua dini mirë emrat dhe mbiemrat.

Të përshëndes këshilltarët, tridhjetë e shtatë këshilltarët e të parit, shtatë këshilltarët e secilit zëvendës të tij, të cilëve po ashtu nuk po ua them emrat, sepse jam po ashtu i ndërgjegjshëm se të gjithëve, meqenëse i shihni e i dëgjoni çdo ditë, shpesh ditë e natë, ua dini mirë edhe emrat edhe mbiemrat.

Të përshëndes edhe kujdestarët, rojat e truprojat, e të parit, e zëvendësve të tij, e ministrave, të zëvendësve dhe të këshilltarëve të tyre, disa prej të cilëve po i shohim qoftë në hapësirën anash karrigeve, qoftë në hapësirën, në galeritë lart, përmbi karriget.

Të përshëndes bashkëshortet e të parit të parë, të përveçar, të parit të dytë, të zëvendësve të të parit të parë, të përveçar, e të të parit të dytë, të ministrave, të zëvendësve e të këshilltarëve të tyre, të cilët ju ftoj t'i përshëndesim me duartrokitje të gjata! Sa më të gjata e sa më jehuese! Sa më trishtuese, më falni desha të them trumbetuese!

Të përshëndes shkëlqesinë e tij të Arsimit, të Shkencës e të Teknologjisë me të gjithë shtatëmbëdhjetë zëvendësit dhe këshilltarët e tij, Asllan Lumjanin.

Të përshëndes të parin e Akademisë së Shkencave e të Arteve tona, shembullor në krejt Europën, i cili me të arriturat e tij shkencore, kimike e fizike e gjeografike, e ka bërë shumë të nderuar kombin tonë duke e kyçur emrin e tij Shqiptar në Bibliotekat më të mëdha e më të lavdishme botërore, shkëlqesinë e tij Hajrush Brushin.

Të përshëndes të parin e fesë së parë në këto troje, imzot Shtjefën Shtjefnin!

Të përshëndes të parin e fesë së dytë në këto troje, të bekuarin Jorgo Sumani!

Të përshëndes të parin e fesë se tretë në këto troje, allahu ekber, Medin Meranin!

Të përshëndes të parët e shoqatave të krijuesve tanë, të shkrimtarëve, të piktorëve, të skulptorëve, të kompozitorëve, të këngëtarëve, të valltarëve, të regjisorëve, të aktorëve të filmave e të teatrove, që janë aq të çmuar e aq të dashur prej shkëlqesive e lartmadhërive tona, të para, të dyta e të treta, e prej gjithë qytetarëve të shtetit tonë krijues, artistik e shkencor.

Të përshëndes mysafiren, besoj për të gjithë ju, më të dëshiruar e më të dashur këtu sonte, bilbilin, zërin magjik të këngës sonë popullore, natyrisht gegënishte, të re e të vjetër, që me atë zërin e saj magjik rrit të vegjël, shëron të sëmurë, trash të hajthëm, ngjall të vdekur, bën largpamës të verbër, e zbukuron edhe këtë sallë, edhe krejt këtë pallat, zonjushën e shkëlqimtë, Arbërie Atjanin.

Me këtë rast, me kënaqësi të veçantë përshëndes edhe vajzat e djemtë që me zërat e tyre, në kor, do ta bëjnë edhe më të jehueshëm zërin magjik të shkëlqesimitares, Arbërie Atjani.

Me këtë përshëndetje, pak të zgjatur, por ndoshta jo shumë bezdisëse, unë dhe gjithë të tjerët që këtu jemi bashkë në këtë kryesi para juve, shprehëm gëzimin tonë të papërmbajtur pse në praninë tuaj kaq të bollshme, kaq të gëzueshme, kaq të vëmendshme, kaq të shkëlqimtë na keni dhënë rastin tua sjellim shfaqjen e artistëve tanë me shkëlqim botëror, titulli i së cilës është *Shenjtorët e mallkuar*.

Menjëherë duhet t'ju them se ky titull është i përbërë prej dy fjalëve, domethënë prej dy gjysmave, që bashkë përbëjnë një tërësi kuptimore dhe simbolike: pra gjysma e parë, domethënë fjala e parë *shenjtorët* është marrë prej



letërsisë franceze, kurse gjysma e dytë, domethënë fjala e dytë, e *mallkuar*, është e jona, është marrë prej letërsisë shqipe, të sotme, dhe është krijuar prej një shkrimtari emrin e të cilit nuk po jua them për arsye se ai, megjithëse nuk e kam takuar që ta pyes, nuk e di nëse do të pajtohej a jo që ta them këtu emrin e tij. Kemi vepruar kështu, e kemi bërë titullin e shfaqjes prej dy gjysmave, dy fjalëve njëra prej të cilave është europiane, kurse tjetra është shqiptare, gjysmë europiane, për arsye se jemi të bindur se gjysma, në të vërtetë gjysmat e shprehin shumë më saktësisht, në histori dhe në përtashësi, prirjen e jetës e të zhvillimit tonë, prirjen tonë historike, prirjen tonë të përtashme, për t'i bërë punët e vogla e të mëdha deri në gjysmë, për t'i lënë punët, qëllimet, ndërtimet, vendimet, mendimet në gjysmë. E kemi bërë Shqipërinë prej gjysmës së popullit dhe gjysmës së gjeografisë, e kemi bërë Kosovën prej gjysmës së hapësirave ku jetonin shqiptarët në ish-Jugosllavi dhe po bëjmë përpjekje të përgjysmojmë edhe më tej çdo gjë, i kemi bërë fetë prej gjysmave - katolike, ortodokse, myslimane, e kemi bërë letërsinë prej gjysmave - shqiptare, kosovare, arbëreshe, e kemi bërë historinë prej gjysmave... e kështu me radhë e pa radhë.

Gjysma është figura jonë!  
Gjysma është metafora jonë!  
Gjysma është simboli ynë!  
Gjysma është fati ynë!  
Vëllezër e motra,  
Miq e dashamirë,  
Shokë e shoqe,  
Zonja e zotërinj,  
Shkëlqesi e shkëlqesësha,

Lartmadhëri e lartmadhëresha!

Shfaqja që do të shihni do t'ju bëjë të qeshni, të gëzoheni, të gajaseni, të duartrokisni shumë, gjatë, si të ishit në ndonjë mbledhje, në ndonjë konferencë, në ndonjë kongres me rëndësi të jashtëzakonshme, në të cilin a të cilën do të shqyrtohen çështje shumë të mëdha, me rëndësi historike dhe në të cilin a të cilën do të merren vendime prej të cilave do të varet jeta juaj e sotme dhe e ardhme, në të cilin a të cilën do të miratohen ligje që do të rregullojnë jetën tuaj të sotme e të ardhme demokratike.

Disa prej jush tashmë filluan të shprehin gëzimin e tyre me zë e me duar, kurse disa të tjerë edhe me këmbë, për çka unë i falënderoj shumë, pamatshëm shumë të gjithë!

Duhet t'ju them, ndoshta jo vetëm i gëzuar, por sadopak edhe i shqetësuar, ndoshta me dufe zemëra, se kjo shfaqje që do ta shikoni sonte, ta shikoni e ta dëgjoni, pavarësisht se do të përfundojë me tri këngë të lartmadhëreshës Arbërie, më falni, të shkëlqeseshës zonjushë Arbërie dhe korit të saj të ri e të bukur, mund t'ju shkaktojë edhe njëfarë mospajtimi.

- Mospajtim, mospajtim, nuk i duam mospajtimet! U dëgjua zëri i njërit nga rreshti i dytë.

- Po, po, mospajtim! Gazi, sado i arsyetuar, që do t'ju shkaktojë shfaqja nuk do të jetë i mjaftë për t'ju mbushur mendjen dhe lukthin me shkëlqim shpresdhënës sepse, siç e dini, të gjithë njerëzit nuk gëzohen njësoj, nuk u gëzohen të njëjtave gjëra, të njëjtave arsye, të njëjtave të mira, të njëjtave bira, të bukura e të dobishme.

Qeshjet e njerëzve mund të përmbajnë edhe thumba, u shpreha gabimisht, e duhej të thosha edhe arsyet, përmbajtjet, të dhënat, lëndët që shkaktojnë gaz, qeshje, mund të përmbajnë edhe thumba më të mprehtë a më të

topitur, që disa njerëzve u pëlqejnë më shumë sesa arsytet, përmbajtjet, të dhënat, lëndët që shkaktojnë gaz.

Për këto arsye gjatë kësaj shfaqjeje, ne presim edhe mospajtime të shprehura ose vetëm me fjalë, ose me mërrrolje pa fjalë, ose me britma të vogla, ose me hallakama, ose me mospajtime të shprehura me duar, me këmbë, ose, në fund të fundit, me mospajtime të shprehura me dalje prej sallës, apo, ndoshta, kushedi, me dalldi a me të ashtuquajturat protesta jashtë sallës.

E kuptueshme! E kuptueshme! Dëgjohet një zë nga rreshti i trembëdhjetë i sallës.

Si e kuptueshme? Si? S'është i kuptueshëm mospajtimi me të parët tanë! Dëgjohet një zë tjetër s'e di në cilin rresht.

Mospajtimet, më falni pse po jua pres fjalën, për artistët janë të kuptueshme, por jo edhe të dëshirueshme, mendoj për mospajtimet me shfaqjen tonë. Ata që punojnë e krijojnë, që lodhen, që s'fllenë sa duhet, që s'arrijnë të hanë bukë e të pinë uiski kur duhet e sa duhet, mospajtimi, megjithatë, është më i dëshiruar sesa heshtja. Anasjelltas e thënë: heshtja është më e padëshiruar se çdo mospajtim. Jo rrallë mospajtimi me punën tënde, me artin tënd, të bën më të njohur e më të dashur prej qytetarëve, më të dashur prej qytetarëve sesa çdo pajtim, çdo duartrokitje, çdo falënderim, çdo dekorim, çdo medaljezim! Çdo karnevalizim! Apo jo!

Tani, pas duartrokitjeve që pamë e dëgjuam për këtë fjalë, të duartrokitjeve të disa të parëve këtu, të të parit të parë, të të parit të dytë e të të parit të tretë, të shkëlqesive e lartmadhërive të tyre, me ardhjen e tyre këtu na gëzuan edhe një ndërkombëtare dhe dy ndërkombëtarë, të cilët na kanë pasuruar qe sa vjet me xhepat e me përvojën e tyre që i kanë sjellë kryeqytetit tonë, shtetit tonë, politikës sonë.

I përshëndes edhe zonjën, edhe zotërinjtë me përzemërsi shumë të përkushtuar, që nuk jam i sigurt se ishte plotësisht e liruar prej dyfytërsisë që herët më të shpeshta zbulon sjelljet tona puthadorëse të viteve të fundit edhe puthakëmbëse! Megjithatë prania e tyre në këtë sallë, në të cilën sonte shfaqen *Shenjtoret e mallkuar*, e shton obligimin tonë që t'i pranojmë zemërgjerë e mendjelartë edhe ato ide, mendime, shaka, qeshje, ironi, sfingëzime e kiçizime që prodhojnë shenjtoret e mallkuar!

Ne jetojmë në demokraci.

Demokratët nuk duhet të tregohen demokratë vetëm në një vend, vetëm në dhomën e fjetjes, në shtratin me gruan, por edhe në jetën e përditshme.

Demokratët duhet të tregojnë demokratë jo vetëm ndaj atyre që duan, por dhe ndaj atyre që mund të kenë arsye të mos i duan.

Harrova të them kur u desh të thuhet se shfaqja *Shenjtoret e mallkuar* jepet sonte për herë të parë, domethënë sonte është premiera e saj.

Aktorët e Teatrit tonë *Modern* shfaqjen e tyre *Shenjtoret e mallkuar* për herë të parë po e shfaqin në këtë sallë të Arkivit, në këtë sallë të madhe e të bukur, e cila është bërë jo për shfaqje teatrore, letrare, muzikore, por për tubime, për sesione, për simpoziume, për konferenca, për kongrese shkencore e mund të jetë edhe për mbledhje, konferenca e kongrese politike e shtetërore.

Shfaqja e *Shenjtoreve të mallkuar* këtu e zgjeron, e shton, e pasuron rolin kulturor të Arkivit tonë shtetëror, e kur them kulturor domethënë kombëtar.

Duke e pasur parasysh të kaluarën tonë, të kaluarën e *Teatrit Modern* e të kaluarën e Arkivit tonë, dikush prej

jush, dikush prej shkrimtarëve që s'janë këtu, dikush prej studiuesve që po ashtu s'janë këtu, apo dikush prej gazetarëve që po ashtu, po ashtu, s'janë këtu dhe prej atyre që, tre po i shoh, janë këtu, mund të thotë apo madje edhe mund të shkruajë se me këtë shfaqje, që ka titull metaforik, dikush do të thotë simbolik e dikush mitologjik, vërtet është shtuar, zgjeruar, pasuruar, simbolizuar, mitologjizuar roli i këtij Arkivi, si institucion jo vetëm shtetëror, por edhe, edhe politik, i dyshueshëm politik e kur them i dyshueshëm politik mendoj i dyshueshëm për një numër njerëzish sot shumë të përkrahur, të çuar përpara prej të parëve tanë.

Dyshimi është virtyt i njeriut.

Dakord.

Dyshimi është ves i njeriut.

Dakord.

Dyshimi është përbërës, më falni frymëzues, i disa veprimeve, masave, ndërmarrjeve që na çojnë ku s'dëshirojmë të shkojmë.

Dakord.

Mosdakord.

Zgjidhni çka të doni, vëllezër e motra, miq e dashamirë, shokë e shoqe, zonja e zotërinj, shkëlqesi e shkëlqesësja, lartmadhëri e lartmadhëresha! Dakordësi a mosdakordësi!

Ndoshta e zgjata pak si më shumë, këtë fjalë timen përshëndetëse. Aktorët, regjisorët, shkencëtarët e sidomos shkrimtarët i kanë fjalët e gjata. Pse jo? Ata jetojnë me fjalë, me tregime, me tregime të gjata, që i zgjasin edhe më shumë, me romane, me drama, me tragjedi e me komedi. Ata jetojnë me to dhe prej tyre! Me fjalë e prej fjalëve, siç e dini, jetojnë edhe ata që bëjnë punë politike, partiake e shtetërore. Por, ndryshe prej aktorëve, regjisorëve,

studiuesve, shkrimtarëve këta, këta që merren me politikë fjalëve të tyre ua shtojnë edhe masat policore, ushtarake, shtetërore, masat që mund të zgjasin a shkurtojnë jetën dhe mund të ndalin a sjellin vdekjen.

Ju ftoj t'u dhurojmë duartrokitje atyre që jetojnë me fjalë dhe prej fjalëve! Duartrokitje pa fjalë, por kush e quan të nevojshme e të arsyeshme le ta përcjellë duartrokitjen e tij edhe me fjalë, me çfarëdo fjalësh që do ai vetë!

Krejt çka s'duroj e ka emrin e vet...

Nuk i duroj pleqtë kur revoltohen dhe presin t'u lirohet vendi në autobus.

Nuk i duroj as të rinjtë. Mendjemadhësinë e tyre. Lavdërimet e tyre me fuqinë që kanë dhe moshën e re në të cilën janë.

Nuk i duroj sherrxhinjtë. Çaraveshjet e tyre të papritura. Pa ndërgjegje dhe të kota...

Nuk i duroj ata që dinë çdo gjë, që janë tolerues dhe plot skrupuj. Që kanë gjithnjë të drejtë. Që janë gjithnjë të përsosur. Që janë gjithnjë të pagabueshëm!

I kritikon e ata të falënderojnë për atë kritikë. I përbuz e ata përzemërsisht të falënderojnë. Me të gjitha të turpërojnë...

Por nuk i duroj as ata që kurrë nuk të shqetësojnë... Gjithnjë të dëgjueshëm dhe plot premtime. Puthadorës besnikë...

Nuk i duroj statujat në sheshe, banjat për zbukurim, filozofët me pamje tërheqëse, banjat me shumë klor..., gratë anoreksive, priftërinjtë dhe ministrat, revolucionarët e rrejshëm, dushin me perde, gjësendet stolisëse... vegjetarianët, muzikën në restorante, festat, mbledhjet, anglicizmat, neologjizmat, udhëheqësit politikë, militantët, prostitutat, personat tepër të shkurtër dhe tepër të gjatë..., telefonat mobilë, burokracinë, kremrat për rrezitje, racistët, pleqtë e rinj dhe të rinjtë pleq, snobët, kirurgjinë estetike, fetë e improvizuara dhe ithtarët e tyre... të gjithë ata që

mbajnë syze për diell, heroinomanët, kokainomanët, seks turizmin, gjenitë, heronjtë, frikacakët, të dëshpëruarit, fitimtarët e çuditur, koprracët, të dëshpëruarit që ankohen ditë e natë.

Nuk e duroj nostalgjinë, keqdashjen, përzemërsinë, pikëllimin, mendjemadhësinë, pajtimin me fatin, vrazhdësinë, fetarizmin, lavdërimin, mendjelehtësinë, vendosmërinë, vetëmëshirimin, papërgjegjshmërinë, nxitimin, mesatarizmin, amaterizmin, varësinë, elegancën dhe lumturinë...

Vetëm një gjë e duroj.

Ngjyresën (Nuancën).

Paolo Sorrentino, *Të gjithë kanë të drejtë*



## **DIALOGU 2: NUK PO ECËN SIÇ ECJE MË PARË**

HAVAJA

Nuk kuptova çka the, Bardh!

BARDHI

Thashë se ti nuk po ecën siç ecje më parë.

HAVAJA

Nuk po kuptoj se ç' do të thuash.

BARDHI

Po them se ti, Hava, qe disa ditë, ndoshta qe dy javë, nuk po ecën siç ke ecur prej se jetojmë bashkë.

HAVAJA

E si po eci?

BARDHI

Po ecën duke e hequr zharg këmbën e djathtë!

HAVAJA

Ndoshta kështu po të duket ty! Po të duket kështu, sepse sivjet nuk jam më ajo që isha para një viti!

BARDHI

Me të gjitha të tjerat je siç ishe përpos me këtë ecje: përpos me zhargitjen e këmbës së djathtë.

HAVAJA

Këto këpucët që po mbaj tash e një muaj dallojnë prej këpucëve që mbaja më parë: dhe janë më të trasha, dhe i kanë takat më të shkurtra!

BARDHI

Ndoshta ecjen e gruas, të gruas e të mashkullit, nuk e caktojnë këpucët, çizmet, patikat, sandalet, çorapët, por diçka tjetër, diçka më e rëndësishme.

HAVAJA

E çka tjetër, Bardh?

BARDHI

Koka?

HAVAJA

Dole ku e ke hallin! Nuk jam më e bukur siç isha më parë për ty.

BARDHI

Mos bëj shaka, Hava, mos! Ti je duke e hequr zharg këmbën e djathtë dhe kjo mua po më brengos, shumë po më brengos.

HAVAJA

Nuk i dinë burrat të gjitha hallet e grave, prandaj as ti nuk i di hallet e mia. Jam edhe vetë fajtores pse nuk t'i kam thënë dhe nuk t'i them as tani. Takat e këpucëve ndikojnë shumë në ecjen e grave, bile edhe në natyrën e tyre. U pëlqejnë shumë edhe pse ndodh t'i mendojnë shumë.

BARDHI

E pse i mban në qoftë se të mendojnë?

HAVAJA

Më mendojnë, por më sjellin edhe kënaqësi, sepse ma mbushin mendjen se me to dukem më e bukur. Dhe, eci më krenarisht.

BARDHI

Më e bukur e më e munduar prej takave!  
Ndoshta pse i mendojnë shumica e meshkujve nuk kanë qejf që gratë e tyre të stolisen me taka!

HAVAJA

Takat e këpucëve ua kanë prishur dikur aq shumë këmbët kinezeve saqë thuhet se pasojat e takave kanë ndikuar frymëzueshëm në revolucionin komunist kinez.

BARDHI

Mos e kthe në shaka shqetësimin tim, Hava, për shkak të ecjes sate duke e zhargitur këmbën e djathtë.

HAVAJA

Askush tjetër nuk e ka vërejtur, përpos teje, dhe nuk më ka thënë, përpos teje, se nuk po eci siç ecja më parë.

BARDHI

Nuk mund ta dish sigurt nëse e ka vërejtur a nuk e ka vërejtur edhe dikush tjetër se ti s'po ecën më siç ecje më parë.

HAVAJA

Po ta zhargitja këmbën e djathtë siç po thua ti, gratë, shoqet e shkollës, sidomos, Gjylshahja, Gjylshahe Ademi, nuk do të duronte pa më thënë, me zë të madh, jo vetëm se po e zhargit njëren këmbë, por, madje, se po shqepoj!

BARDHI

Të tjerët, burra e gra, të keqen e tillë, zakonisht, ta thonë kur bëhet vonë, kur nuk i gjendet ilaçi.

HAVAJA

A vetëm sytë e tu shohin çka nuk shohin sytë e vajzës e të djalit tim, a?

BARDHI

Vajza e djali! Anila e Liku! E ku i ke?

HAVAJA

Anila e nënës! Liku i nënës! Qyqja unë për ta! Qe sa kohë nuk i kam parë!

BARDHI

Sytë e mi e shohin edhe ndryshimin më të vogël në trupin tënd, në sjelljet e tua, në mendimet e tua, apo jo. Unë të kam grua, qe sa vjet, unë të dua qe sa vjet, unë do të dua deri në fund të jetës, prandaj e shoh edhe ndryshimin më të vogël në ty, Hava. Hava!

HAVAJA

Edhe sytë e mi shohin mirë, shumë mirë, unë nuk mbaj syze si ti, sepse i kam sytë e shëndoshë.

BARDHI

Apo vëren ti ndryshim tek unë, në ecjen time?

HAVAJA

Po vërej, si s'po vërej.

BARDHI

Çka po vëren?

HAVAJA

Po e mban kryet siç s'e mbaje herëve të tjera as kur shëtitnim nëpër këto livadhe, as kur bisedonim e as kur heshtnim!

BARDHI

E si e mbaja kryet herëve të tjera e s'po e mbaj tani?

HAVAJA

Dikur e mbaje kokën drejt, shikoje përpara, kurse tani, qe disa kohë, e lëviz shumë atë kokë, sa e mban drejt, sa e shtrembëron, sa e kthen majtas, sa djathtas, sa mbrapa; ata në Tiranë nuk do të thoshin mbrapa, po mbrapsht! Koka jote është bërë si top futbollit!

BARDHI

Hava! Hava! Çka po dëgjoj prej teje! Koka e burrit tënd si top futbollit! Ia qepojnë me këmbë të djathtë a të majtë dhe e hedhin ku të duan të gjithë ata që s'e duan.

HAVAJA

S'mendova ashtu, jo.

BARDHI

Hava, koka ime është siç ishte, por ecja jote ka ndryshuar; ti je duke e zhargitur këmbën e djathtë dhe kjo mua po më shqetëson. A po vëren edhe ti se këmbën e djathtë je duke e lëvizur me mundim, duke e hequr zvarrë?

HAVAJA

Po, po vërej se këmbën e djathtë po e lëviz disi më lodhshëm, më lodhshëm, por po mendoj se nuk do më zgjasë shumë ky mundim.

BARDHI

A ke dhembje në këmbën e djathtë?

HAVAJA

Jo, nuk kam dhembje.

BARDHI

Mund të jetë mirë, por mund të jetë keq që nuk ke dhembje në këtë këmbë.

HAVAJA

Edhe mirë edhe keq! A rrinë bashkë ato?

BARDHI

Do të shihet. Rrinë bashkë e s'i shohim se janë bashkë.

## ARKIVI - ÇFARË FJALE!

Nuk e di a do të më sjellë fat apo fatkeqësi, më mirë të them gëzim a dëshpërim, puna e përkthyesit në këtë institucion me emrin arkiv.

Arkiv! Çfarë fjale!

Fjalë e jashtëzakonshme.

Fjalë e jashtëzakonshme qoftë edhe pse në përbërjen e saj, si bazë e saj, është fjala *ar*.

Ar! Ar-kiv!

Unë nuk mund ta di, mund ta dinë gjuhëtarët, e gjuhëtarët, si fjala vjen ai, Idrizi. Idriz Ajeti, ajo, Shefkija, Shefkije Islamaj, a ai, Isaja, Isa Bajçinca, se si i është shtuar *ar*-it shtesa *kiv* (*ar+kiv*)! Ata, gjuhëtarët, merren edhe me parashtesat, messhtesat e prapashtesat. Me shumëçka, që ka të bëjë me gjuhën, merren ata.

Arkivi! Është fjalë e lashtë, sigurisht e krijuar prej të pasurve, prej shtetit të pasur dhe prej njeriut të pasur, që kishte *ar* dhe ia dinte vlerën arit! E të pasur në atë kohën e tyre ishin grekët e lashtë; por më të pasur, shumë më të pasur se ata, ishin romakët, romakët e lashtë e jo romakët e sotëm, megjithëse edhe këta të sotmit hyjnë ndër të pasurit.

Ne, të varfër qysh ishim, edhe në kohën e vjetër, besoj se arkivin e kemi marrë prej tyre, prej romakëve të vjetër e jo prej romakëve të sotëm, megjithëse edhe prej këtyre të sotmëve, sot mendoj të njëqind vjetëve të fundit, na

janë dhuruar një sërë fjalësh të reja. Me këso dhuratash të çmuara, dhurata foljore, ishim të dhuruar më së shumti në kohën e atij që kishte fytyrë gjeometrike, që i dinte gjashtë gjuhë të huaja, si unë, që shkruante dhe drama, si unë që po e shkruaj dramën time dhe të Havasë, si quhej, si...? Benito. Benito Musolini. Duçe.

Edhe grekëve, edhe romakëve të lashtë, e romakëve ndoshta më shumë se grekëve, u duheshin shumë arkivat. Ishin shtrirë në tri kontinente - në kontinentin e Europës, në kontinentin e Afrikës dhe në kontinentin e Azisë. Ishin shtrirë si sundues. Kishin çka, çka, kishin shumëçka të fusnin, të fusnin e të ruanin në arkiva. Gjithfarë shkrimesh, gjithfarë dëshmish. Shkrime në pllaka guri, shkrime në tulla, shkrime në lëvore drunjsh, shkrime në drunj mesatarisht të trashë, shkrime në çka krejt tjetër, shkrime në lëkura të shtazëve, shkrime në brirë të shtazëve, më së shpeshti të elefantëve. Shkrime me emra, me ngjarje, me vdekje, me lindje, me të dënuar e me të falur, me shenjtorë e me mëkatarë, me ëndrra, me mendime, që dikur, më vonë, do t'i quajnë shkencore, letrare, filozofike e s'di si krejt ndryshe. Shkrime për familjen, për fisin, për shtetin, për tokën, për gjithësinë, për gjeometrinë, për aritmetikën, për fizikën, për kiminë. Shkrime për burrëri! Shkrime për qyqari! Shkrime për të bukurën në veprat letrare, në pikturat, në skulpturat e në arkitekturat, por edhe për të bukurën e atyre bukurosheve të tyre që do t'i bëjnë të paharruara në historinë greke e romake. Në arkivat e lashtë romakë, por edhe grekë, ka shkrime, dëshmi, edhe për të bukurën në tokë. Dijetarët e Aleksandrit të Maqedonisë, që kishte marrë me vete në ato përshtrirjet e tij ushtarake, që njëkohësisht ishin dhe diturore, do t'u sjellin arkivave grekë shumë shkrime,

shumë dëshmi, për bukuritë e tokave ku do të mbërrijnë.

Edhe më shumë se grekët e lashtë do t'u sjellin shkrime, dëshmi, për tokat e pushtuara europiane, afrikane dhe aziatike, dijetarët romakë.

Naimi ynë, Naim Frashëri, me të vëllanë e tij, Samiun, nuk e quante gjeografinë gjeografi, donte ta quante shqip, prandaj dhe shqip do të bëjë fjalë shumë të bukur për të: dhe shkronjë.

E kremtova ditën e punësimit në arkivin tonë qendror, shtetëror. Një herë e kremtova me miqtë e shokët në restorantin *Zodiaku* e, mandej, në mbrëmje, me familjarët. Vendosa ta kremtoj kështu dyfish punësimin pasi mendova për të: për kuptimin e fjalës përkthyes arkivist, çka u bëra sot, ditën që kremtova? Përkthyes isha, i bërë që disa vite. E tani, e sot, u bëra edhe arkivist!

Arkivist! Ar - kivist!

Në mendjen time arkivi u bë fjalë me dy kuptime.

Kuptimi i parë: arkivi është dhoma, hapësira, godina, ndërtesa ku futen e ruhen gjëra të ndryshme, më së shumti shkrime të ndryshme, dokumente të ndryshme, me prejardhje të ndryshme e për çështje të ndryshme. Në arkiv mund të futen dhe janë futur e futen edhe dorëshkrime të ndryshme me rëndësi të ndryshme, si, fjala vjen, dorëshkrimet e Platonit, të Aristotelit, të Heraklitit, të Demokritit pavarësisht a janë shkruar në pllakë guri, në lëvore a copë druri, në tullë a në lëkurë, dorëshkrime të Dekartit, të Dantes, të Servantesit, të Shekspirit, të Kantit, të Hegelit, të Marksit. Dhe, natyrisht, të Enverit. Enver Hoxhës. Në arkiva janë futur edhe versionet e bukurshkrimeve të ndryshme të *Biblës* e të *Kur'anit*. Në arkiva janë futur edhe recetat e ndryshme të ilaçeve që i jepeshin Niçes pasi ishte çmendur, recetat e ilaçeve që i



jepeshin Karlit të Madh, por jo edhe recetat e ilaçeve që i jepeshin Napoleonit në Elbë.

Kuptimi i dytë, i figurshëm: arkivi është dhoma, godina, qelia, hapësira e imagjinuar shumë e gjerë a shumë e ngushtë në të cilën vendosen të gjithë ata që sillen, veprojnë e flasin siç s'duan tiranët, despotët, diktatorët që të sillen, që të veprojnë, që të punojnë dhe të gjithë ata të dëgjueshmit e mjerë, të shkretë, të sflitur, që mund të përdoren apo që janë përdorur dikur, pavarësisht pse nuk përdoren më.

Çoje në arkiv, mbyllja derën arkivit, mbyllja mirë derën arkivit që të mos shihet më!

I duam dhe s'i duam arkivat! Dyshojmë në arkivat! Besojmë në arkivat!

Të nevojshëm, të dobishëm, sa arkivat që i duam, janë edhe arkivat që s'i duam. Rrofshin arkivat! Mos qofshin arkivat!

E dua shumë arkivin tim. Kam futur shumëçka në të. E marr me mend se dikur disa do të jenë të gëzuar, të përnderuar pse janë futur në arkivin tim; por disa të tjerë do të jenë shumë të shumëdyshuar, të hidhëruar, të dëshpëruar, të lemerisur pse janë në të.

Në arkivin tim ka dokumente për një varg shkrimtarësh, por më së shumti për Dhimitrin, Dhimitër Shuteriqin, Dritëroin, Dritëro Agollin, Ismailin, Ismail Kadarenë, Ramizin, Ramiz Kelmendin, Eqremin, Eqrem Çabejn, Androkliun, Androkli Kostallar, për Idrizin, Idriz Ajetin, për Shefkijen, Shefkije Islamajn, e për disa krijues të tjerë.

Në arkivin tim ka shumë të dhëna e gjykime për shumicën e këtyre që sundojnë sot. Shyqyr Zotit që s'do të kenë mundësi t'i lexojnë!

Mendoni çka të doni për arkivat, por mos harroni se në arkivat, së bashku në arkivat shtetërorë dhe në arkivat privatë, ruhet historia e vërtetë e çdo populli dhe e çdo shteti.

Edhe historia e Tokës ruhet në arkiva.

Toka, një ditë, kur të harxhohet Dielli, do të zhduket e me të edhe historia e njerëzimit, por pamja e Tokës, e qytetërimit dhe e kulturës së saj, do të ruhet në ndonjërin prej trupave qiellorë në të cilin do të mbërrijë njeriu para se të zhduket Toka, që nuk do të jetë i varur prej Diellit siç ishte e varur Toka jonë e ndjerë.

O, sa shumë do të doja të isha specie njerëzore e atij trupi qiellor, emri i të cilit ende s'dihet, që do të përshkruante në vepra letrare, do të filmonte në filma artistikë e do të pikturonte në piktura gëzimet e dhembjet, shpresat e dëshpërimet, ngadhënjimet e Tokës me njerëzimin e saj të përmortshëm.

Qoftë i përjetshëm emri yt, Tokë!

## RAPORT

Mbi bisedën me informuesin tonë, që ka nofkën Miftar Mali, të bërë me 3 nëntor 1998, duke filluar prej orës 22 e deri në ora 23 e 30, në hotelin *Nirvana*, dhoma nr. 7, kati i dytë.

UNË: me të dhënat e tua jetëshkrimore do ta fillojmë këtë bisedë të sotme, më 3 nëntor të vitit 1998.

AI: Kuptoj.

UNË : Emri i shënuar në emërtuesin e të lindurve?

AI: Myftar, jo Miftar!

UNË: Mbiemri?

AI: Mali.

UNË: Viti i lindjes?

AI: 1964.

UNË: Dita dhe muaji?

AI: 13 mars.

UNË: Vendlindja?

AI: Lugu i Verrave.

UNË: Vendbanimi i sotëm?

AI: Kryeqyteti.

UNË: Profesioni?

AI: Ende i pacaktuar.

UNË: Beqar a i martuar?

AI: I martuar.

UNË: A keni fëmijë?

AI: Tre djem e një vajzë.

UNË: Gjatësia trupore?

AI: 187 centimetra.

UNË: A jeni i kënaqur me gjendjen materiale që keni sot?

AI: Më shpesh jo se po.

UNË: A keni qenë anëtar i Lidhjes Komuniste?

AI: Po.

UNË: Prej kur?

AI: Prej 26 shtatorit të vitit 1985.

UNË: Prej kur s'jeni?

AI: Prej se u shua vetë Lidhja Komuniste.

UNË: Anëtar i cilës parti jeni tani?

AI: Nuk dëshiroj t'i shënohet emri, sepse shpejt do të dal prej saj.

UNË: Pse do të dilni prej saj?

AI: Sepse udhëheqja e saj është e korruptuar politikisht, financiarisht dhe shpirtërisht.

UNË: Cilën ideologji përkrahni?

AI: Ideologjinë liberale!

UNË: Liberal! Cilin rend politik, shoqëror dhe kushtetutar përkrahni?

AI: Rendin kapitalist.

UNË: Jua bëra disa pyetje që drejtpërdrejt nuk kanë të bëjnë me temën për të cilën jemi takuar.

AI: Ju kuptoj, jeni hetues i specializuar.

UNË: A keni mbledhur mjaft të dhëna për çështjen për trajtimin e së cilës jemi takuar: për UÇK-në.

AI: Për asgjë s'mund të dihet krejt çka do të ishte e nevojshme të dihej!

UNË: Çka është UÇK-ja?

AI: Organizatë politike që përpiket të bëhet ushtarake.

UNË: Kush është themeluesi i saj?

AI: Ata që përmenden si themelues të saj janë vetëm zbatues të kërkesave të themeluesve, formuesve të saj të vërtetë.

UNË: E kush janë themelues të saj të vërtetë?

AI: Shefat e Sigurimit Shtetëror të Shqipërisë së Enver Hoxhës.

UNË: Enver Hoxha ka vdekur në vitin 1985 e UÇK-ja është formuar tani vonë, në vitin 1997, po thonë disa, kurse në vitin 1992, po thonë disa të tjerë.

AI: Enver Hoxha ka vdekur në vitin 1985, por ideologjia e tij dhe sigurimi i tij vazhdojnë të jetojnë në kokat e atyre që rrahin gjoksin se kanë themeluar UÇK-në!

UNË: Pse jeni kundër UÇK-së?

AI: Jam kundër saj, sepse me emrin e saj dhe me terrorizmin e saj ajo do t'i sjellë fatkeqësi Kosovës dhe shqiptarëve të saj.

UNË: A do të jeni kundër saj edhe në qoftë se do ta përkrahin SHBA-ja dhe Bashkimi Europian, çka duket se do të ndodhë?

AI: SHBA-ja dhe BE-ja e kanë përkrahur, e përkrahin dhe do ta përkrahin Lidhjen Demokratike të Kosovës me partitë e tjera që mbahen me të e jo atë organizatë terroriste që bën çmos ta zhdukë LDK-në!

UNË: Sa anëtarë mendoni se ka ajo organizatë politike që përpiket të bëhet ushtarake me emrin UÇK?

AI: Shumë më pak se ç'deklarojnë zëdhënësit e saj gjysmanalfabetë!

UNË: Përafërsisht sa mund të jetë numri i atyre pjesëtarëve të saj që vishen me do farë uniformash të arnuara në Shqipëri?

AI: Në qoftë se zëdhënësit e saj thonë 10.000, atëherë mund të supozohet se do të jenë 2000 deri në 3000 pjesëtarë.

UNË: Në cilat anë të Kosovës ka grupe të UÇK-së?

AI: Në Drenicë janë disa grupe, mandej në anën e Deçanit më pak, ndonjë grup i vogël në Llap, në Ferizaj e në Kaçanik. Kaq.

UNË: A ka gra në radhët e UÇK-së?

AI: Me gishtërinjtë e njëjës dorë mund të numërohet numri i tyre.

UNË: A ka të shkolluar në radhët e UÇK-së?

AI: Zëdhënësi i saj thotë se numri më i madh i pjesëtarëve të UÇK-së janë me fakultete të kryera. Kjo është rrenë. Numri më i madh i tyre janë fshatarë, dukshëm më pak punëtorë, me shkollë tetëvjeçare të kryer e të pakryer. Është edhe një numër i vogël i studentëve që nuk i kanë kryer fakultetet.

UNË: Përpos prej Kosovës a ka pjesëtarë të UÇK-së edhe prej viseve të tjera ku jetojnë shqiptarë në Jugosllavi?

AI: Një numër i vogël janë nga Maqedonia, një numër edhe më i vogël janë nga Mali i Zi dhe fare pak nga ana e Preshevës.

UNË: A ka pjesëtarë të UÇK-së prej Shqipërisë?

AI: Më shumë se ç'mendohet.

UNË: Ashtu, a?!

AI: Prej Shqipërisë janë edhe disa oficerë të ushtrisë së Enver Hoxhës. Ata edhe i bëjnë planet e quajtura strategjike - plane të sulmeve e të mbrojtjeve të UÇK-së. Ata e quajnë veten strategë të UÇK-së.

UNË: A e njihni ndonjërin prej tyre?

AI: Jo.

UNË: A e keni dëgjuar emrin e ndonjërit prej tyre.

AI: Njëri prej tyre, me gradën gjeneral, quhet Kudusi, Kudusi, nuk po më kujtohet mbiemri i tij.

UNË: Në grupet e UÇK-së a ka ndonjë oficer nga Armata Popullore e ish-Jugosllavisë?

AI: Jugosllavisë? Flitet për disa prej tyre.

UNË: A e dini emrin e ndonjërit prej tyre?

AI: Komandanti i sotëm i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së më duket se quhet Agim Çeku, oficer, nuk e di kolonel a çka në Armatën e ish-Jugosllavisë në Kroaci dikur.

UNË: A mendoni se UÇK-ja mund të organizojë luftë frontale apo vetëm luftë partizane?

AI: UÇK-ja nuk ka bythë për luftë frontale.

UNË: Ku ushtrohen pjesëtarët e UÇK-së?

AI: Disa në Shqipëri, kurse shumica askund, janë luftëtarë bashibozukë!

UNË: Ku e merr armatimin UÇK-ja?

AI: Kryesisht në Shqipëri.

UNË: Kush e financon UÇK-në?

AI: E financojnë shqiptarët e pasur nga SHBA-ja, nga disa vende të Bashkimit Europian, nga Kanadaja e Australia.

UNË: A e dini për çka krejt përdoret Fondi *Vendlindja thërret*?

AI: Përdoret për blerje armësh, për uniforma, për pajisje të tjera të ndryshme të grupeve të ndryshme të UÇK-së, për shpenzimet e ndryshme të drejtuesve ushtarakë e politikë të UÇK-së. Flitet se një pjesë e madhe e të hollave, që përbëjnë këtë Fond, fshihet në banka në Europë dhe në qypa në arat e livadhet e drejtuesve politikë e ushtarakë të UÇK-së!

UNË: Mos ju lodha me gjithë këto pyetje?

AI: Nuk jam shumë më i vjetër se ju.

UNË: Unë dhe Shërbimi im kërkojmë prej teje që për takimin e ardhshëm të na siguron mundësisht: emrat e numrit më të madh të financuesve të UÇK-së në SHBA, në shtetet europiane, në Kanada, në Australi, në Zelandën e Re, e kudo tjetër janë; emrat e oficerëve nga Armata Popullore e ish-Jugosllavisë, që janë inkuadruar në UÇK; emrat e oficerëve dhe pjesëtarëve të Ushtrisë së Shqipërisë që bëjnë pjesë në radhët e UÇK-së; dhe, në fund, emrat e shqiptarëve nga Maqedonia, Mali i Zi dhe ana e Preshevës, që bëjnë pjesë në UÇK.

AI: Do të përpiqem.

UNË: Shërbimi im është i gatshëm t'u heq shpenzimet gjithë atyre që do t'ju ndihmojnë në mbledhjen e të dhënave.

AI: Faleminderit.

UNË: Mirë u takofshim, Miftar!

Shefi i Sigurimit  
të Brendshëm Shtetëror  
Për Kosovë e Metohi,  
Stanimir Samojllloviq



### DIALOGU 3: SA MË HERËT, AQ MË MIRË

HAVAJA

Ti s'e do të djathtën!

BARDHI

Njësoj i dua të dyja këmbët e tua.

HAVAJA

Njësoj! Jo! Ti e do të majtën më shumë apo jo?

BARDHI

Unë dua që të dyja këmbët e tua të jenë të shëndosha,  
Jo të sëmura siç është e sëmurë e djathta tani.

HAVAJA

A e ke përnjëmend?

BARDHI

Shumë përnjëmend.

HAVAJA

E çka duhet të bëj?

BARDHI

Mos thuaj çka duhet të bëj, por thuaj çka duhet të bëjmë.

HAVAJA

Çka duhet të bëjmë, pra?

BARDHI

Duhet të të çoj te mjeku.

HAVAJA

Te mjeku? Çfarë mjeku? S'jam unë për mjek.

BARDHI

Më mirë herët se vonë, Hava. Të shkojmë te një mjek specialist.

HAVAJA

U bëra për specialist, a, qyqja unë!

BARDHI

Specialisti na thotë çfarë ilaçesh duhet të pish që të mos e heqësh më zharg këmbën.

HAVAJA

Që të mos e heq zharg këmbën e djathtë!

BARDHI

Të duhen ilaçe.

HAVAJA

Të pi barna pa pasur dhembje!

BARDHI

Kur shfaqen dhembjet ilaçet ndikojnë më pak; sa më herët, aq më mirë.

HAVAJA

Ka kohë që më dukej se kur i kaloja pragjet e dhomave e çoja më vështirë këmbën, të djathtën. Nuk të kam treguar, nuk doja të të bëj vesvese. E di se ti bëhesh lehtë vesvese!

BARDHI

Është dashur të më tregosh.

HAVAJA

Gratë ngurrojnë t'ua tregojnë burrave dobësitë e veta.

BARDHI

Paske harruar çka shkruan në dëftesën e kurorëzimit.

HAVAJA

Çka?

## BARDHI

Shkruan se burri e gruaja janë me ligj të obliguar që t'ia thonë njëri-tjetrit të gjitha dhe të bëjnë çmos për njëri-tjetrin kur sëmuren a kur pësojnë farë fatkeqësie. Në qoftë se nuk e bëjnë këtë jo vetëm se turpërohen, por edhe dënohen.

## HAVAJA

Unë nuk jam e sëmurë, po të tregoj se nuk jam e sëmurë, kurrkund nuk po më dhemb edhe pse po e ngre zharg këmbën e djathtë.

## BARDHI

Kjo zhargitje qoftë edhe vetëm e njëres këmbë është një sëmundje.

## HAVAJA

Mos më bë vesvese, të lutem.

## BARDHI

Dhëntë Zoti e të mos kesh asgjë të keqe. Por, unë kam biseduar me mjekun, doktor Bamirin, kur isha për të marrë vaksinën kundër gripit. I tregova se je duke e ngrehur zharg këmbën e djathtë. Më pyeti se qysh kur?

I thashë se për herë të parë, kur ishim duke shkuar te një kala në vendlindjen time, që quhet Shkëmbi i Kalasë, vërejta se po e zhargiste këmbën e djathtë. Kur ecnim nëpër rrugë të paasfaltuara çohesh pluhur e kur ecnim nëpër rrugë të asfaltuara dëgjohej fërkimi në asfalt!

## HAVAJA

Çohesh pluhur?

## BARDHI

Po.

## HAVAJA

Dhe dëgjohej fërkim?

BARDHI

Po.

HAVAJA

Pos teje, Anilës e Likut, a e di edhe kush tjetër se unë po e  
tërheq zharg këmbën e djathtë?

BARDHI

Ndoshta edhe ndonjëra nga shoqet e tua, në shkollë.

HAVAJA

S'jam parë me asnjërën prej se kanë filluar pushimet e  
verës.

BARDHI

Po ti, kur ishim në qytet, njëherë në muaj dilje në drekë  
me tri shoqet e Shkollës Normale.

HAVAJA

Uuu, po, kam harruar. Kam filluar të harroj.

## NUK TË LË ZOTI REHAT

Kur mendon se i ke punët më së miri të kërcet prej nga s'e pret!

Pret bekim e të del mallkim!

Të papriturat, nuk e them unë i pari po e kanë thënë të tjerë më të mençur se unë, e sundojnë botën. E caktojnë fatin e njeriut. I nisin luftërat dhe i lidhin paqet.

Më janë rritur fëmijët, djali, Liku, ka kryer fakultetin, është bërë dramaturg, por me punën e dramaturgut nuk sigurohet as buka e gojës, prandaj duhej të kryente edhe një fakultet tjetër, një fakultet për bukën e gojës. Tani po studion mjekësinë.

Vajza, Anila, është në vitin e fundit të studimeve, në Fakultetin Ekonomik, do të bëhet shpejt ekonomiste, po ekonomiste, në një vend në të cilin të gjitha punët e ekonomisë i caktojnë, i shtojnë a i zvogëlojnë minjtë e zyrave, po jo edhe nevojat dhe kërkesat e qytetarëve! Specializohet në Holandë, në Amsterdam.

Ka ndryshuar rendi, nuk jemi më në atë rendin, në të vërtetë, në atë rendin e fortë që mosdruessit e çdo rendi e quanin mosrend, komunizëm, por prapë kemi rend duke qenë të sunduar prej sunduesve të ardhur!

Edhe Liku edhe Anila do të bëhen vetë të dytë, i kanë gjetur djali shoqen e vajza shokun e jetës. Dhe, kushedi a do ta vazhdojnë jetën me ne, me mua dhe me Havanë apo do

të shkojnë përgjithmonë ku po shkon numri më i madh i të rinjve: jashtë, në Amerikë, në Nju-Jork Liku e në Holandë, në Amsterdam, Anila. I kanë gjetur lidhjet. Këta të rinjtë e sotëm ndryshojnë shumë prej të rinjve të brezit tim, madje dhe të brezit të para tyre: e mendojnë botën si të ishte e gjitha shtëpia e tyre, po, shtëpia e tyre e punuar prej babait e nënës. As udhëtimi me tren, as udhëtimi me aeroplan, as udhëtimi me anije nuk i lodh aspak! Kur u them se në aeroplan unë bëhem nëntë kilogramësh ata qeshin, qeshin pa u ndalur thuajse po dëgjojnë shakatë e Fernandelit; nuk thashë të XY-së, i cili më bën më shumë se Fernandeli që të qesh, sepse për humoristët e huaj, të Francës, të Italisë a të Britanisë dinë më shumë se për humoristët e vendit, më shumë se për humoristët e Shqipërisë.

Edhe vetë i kam punët mirë, punët mirë me punën time, me punën e përkthyesit arkivist. S'ë kam menduar se puna e përkthyesit në arkiv, që i thonë përkthyes arkivist, është farë pune e rëndësishme dhe e çmueshme, por nuk mendon edhe Ai si unë. Shumëkush, sidomos intelektualët, Saniu, Sani Caku dhe Sejdiu, Sejdi Lipa, janë shumë të interesuar të dinë se çka ka në arkiva, çka fshihet në to, çka fshihet në arkivat e kohës së komunizmit e çka në arkivat e kohës së sotme, të quajtura arkiva të demokracisë, të demokracisë, thotë Ai, Saniu, të kësaj demokracie, të cilën po e shkërdhejnë prej të dyja anëve, prej përpara dhe prej përmbra, prej mbrapsht thonë në Tiranë, thotë Ai, Saniu, dhe thonë ata Sejdiu e Sedati, Sedat Lamaxhiu, që më mirë se Ai, Saniu, dinë si shkërdhehen dosjet arkivore!

Por, por, por për arkivat e për arkivizmin nuk lodhen vetëm intelektualët, gjysmat dhe çerekët e tyre, që përmenda dhe s'përmenda, por edhe ish-politikanët, Mahiri dhe Koleci,

ata që ishin në pushtet në kohën e komunizmit e tani jetojnë me pensione. Të mos harroj të tregoj se disa prej shokëve të tyre, edhe këtu, në Prishtinë, edhe atje, në Tiranë, janë futur në pushtet dhe sundojnë siç sundonin dikur vetë apo me bijtë e me bijat e tyre. Të gjithë ata, si të Mahirit e si të Kolecit, duan të dinë, shumë duan të dinë, se çka ka në arkiva. Në qoftë se intelektualët, me gjysmat dhe çerekët e tyre, të shkretët, duan të dinë, bëjnë çmos që të dinë, se çka ka në to për ta, çfarë shënimesh gjenden në arkiva për ta, për sundimin e tyre, thonë, ata të politikës duan të dinë a janë në arkiva të ruajtura të gjitha kontrimutet e tyre bashkë me kontributet e atyre intelektualëve, atyre gjysmë e çerek intelektualëve të tyre, të Samiut, Sejdiut e Sadatit, të gjitha kontributet e kontrimutet e tyre informuese, kallëzuese, bashkëpunuese, agjentuese me, me kënd se, me jorgoviqët, stijoviqët, mihajlloviqët e iqët e viqët e tjerë. Edhe të parët, edhe të dytët, edhe dyshi, edhe treshi dikur kanë dëshiruar, shumë kanë dëshiruar, kanë bërë çmos që të lënë gjurmë, gjurmë sa më të gjera e sa më të thella në historinë tonë, por atëherë në kohën e tyre, nuk janë lodhur shumë të mendojnë se si do të shikohen dikur ato gjurmë, çfarë do të jenë ato gjurmë, si do të kuptohen e si do të çmohen dikur: të mëdha, të vogla, të mira, të këqija, të ndershme, të poshtra, me këpucë, me opinga, me çizme, me çizme të fabrikës së Milanos a të fabrikës së Nishit? E tani janë në hall të madh, bëjnë shumë përpjekje për t'i zhdukur ato gjurmë prej arkivave. Dhe, disa prej tyre, qoftë ata të tre, qoftë ata të dy, i gjejnë zhdukësit, kryesisht trepërçikët e tyre!

Ai, a e dini kush është ai, dikush e di e dikush s'e di, por edhe ata që e dinë bëhen se nuk e dinë. Ai, Agush Ollmani,

ka bërë çmos që të pastrojë arkivat prej kontributeve, apo, siç thoshte Ramiz Kelmendi, prej kontrimuteve të dikurshme të tij, të atij Ai-t? Tani disa të tjerë, që i ka dashur dikur dhe nuk i do sot, i quan mëkatarë të djeshëm, kurse vetveten e quan shenjtor! Djalli i djeshëm shenjtor i sotëm! Sa vështirë është të kesh punë me djallin e shenjtëruar, s'e di kur të del e prej nga të del, përpara a përmbropa! Ruana Zot prej tij! Dhe prej ndihmësve të tij, trepërçikëve të tij, se vetë, pa ndihmën e Zotit, nuk mund të ruhemi prej tyre!

Eh, arkivat! Sa të rëndësishëm e sa të rrezikshëm janë!

Arkivat janë magazinat e lavdive!

Arkivat janë bodrumet e prishësive!

Arkivat janë përcaktues të mendimeve të historisë!

Arkivat janë bibliotekat e historisë!

Arkivat janë enciklopeditë e historisë!

E arkivistët? Kush janë arkivistët? Çka janë arkivistët?

Arkivistët janë historianët e vërtetë të historisë, edhe pse historianët zyrtarë i konsiderojnë punëtorë të tyre, punëtorë fizikë të tyre!

Arkivistët janë autorët fizikë më të mëdhenj të historisë!

Dhe, më tej, çka mund të thuhet më tej për arkivistët?

Mund të thuhet:

Arkivistët janë prokurorët e heshtur të historisë!

Arkivistët janë gjykatësit e heshtur të historisë!

Arkivistët janë dëshmorët e historisë!

Arkivistët janë heronjtë e historisë!

Qe, sa mirë, unë si përkthyes arkivist jam edhe dëshmor, edhe hero i historisë! Nuk jam ende, por duhet të bëhem edhe dëshmor, edhe hero i historisë!

Por, a mund të jenë arkivistët edhe mëkatarët e historisë, edhe komprometuesit e historisë?



Varet si sillen në arkiva, si e tregojnë, si e ruajnë, si e japin, kujt ia japin për përdorim apo si e përdorin vetë lëndën e arkivave. Biblën e arkivave!

Unë jam më shumë se vetëm arkivist!

Unë jam edhe përkthyes arkivist!

Nuk do të doja të më quajnë përkthyes arkivist!

Do të doja të më quajnë vetëm përkthyes!

E lodh mendjen duke menduar mirë e keq për arkivistët - çka jam edhe vetë e para syve të mi Havaja, e lodhur, si e pikëlluar, duke hequr zharg këmbën e djathtë! Hava, Havaja ime.

## RAPORT

Për bisedën me Hikmet Sadikun të bërë me 17 maj 1998 në pyllin që ndan fshatin e tij prej fshatit tim.

Ky raport u shkrua sot, më 17 maj 2002, në bazë të kujtimeve për atë bisedë dhe u shkrua i kërkuar prej Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, tani e quajtur Forca e Sigurisë e Kosovës.

UNË: Mirëmbërëma, shoku Hikmet.

AI: Mirëmbërëma, zotëri Gajret...

UNË: Prej eprorëve të mi jam i caktuar që të bëj një bisedë informuese me ty për disa çështje.

AI: Bisedë informative?

UNË: Dikur i thuhej ashtu siç the ti e sot i themi siç thashë unë: informuese.

AI: Mirë, mirë, si informuese si informative - e njëjta gramatikë! Dhe, e njëjta politikë! Me të njëjtat po-ja e bujë!

UNË: Këqyr çka po flet!

AI: Këqyr dhe ti çka do të pyesësh!

UNË: Së pari, duhet t'i shënojmë të dhënat themelore për ty.

AI: Të dhënat themelore?! Cilat?

UNË: Cili është emri dhe mbiemri yt i shënuar në regjistrin e të lindurve, që ruhet në Komunë, në qytet.

AI: Emri dhe mbiemri im, i shkruar në atë regjistër, është Hiqmet Sadiku.

UNË: Jo Hikmet?  
AI: Hiqmet, jo Hikmet.  
UNË: Emri i babait?  
AI: Refik.  
UNË: Emri i nënës?  
AI: Zarife.  
UNË: Viti i lindjes?  
AI: 1973.  
UNË: Dita dhe muaji i lindjes?  
AI: 23 prill.  
UNË: Vendlindja?  
AI: Siç e di unë e di edhe ti, po shkruaje si të duash!  
UNË: Vendbanimi i tanishëm?  
AI: Ai i lindjes.  
UNË: A je i martuar?  
AI: Po.  
UNË: Cili është emri i bashkëshortes?  
AI: Hake.  
UNË: E mbiemri?  
AI: Kollari.  
UNË: A keni fëmijë?  
AI: Po.  
UNË: Sa?  
AI: Tre deri tani.  
UNË: Me çka merresh gjatë ditës?  
AI: Me shumë punë. Me punë në shkollë, në arë, në livadh: ruaj dy lopët që kemi, i këqyri fëmijët, dal e blej gjëra ushqimore për familjen e të tjera.  
UNË: A të vijnë mysafirë ndonjëherë?  
AI: Vijnë nganjëherë.  
UNË: A shkon ti mysafir?

AI: Nganjëherë.

UNË: Te kush?

AI: Te miqtë dhe te fqinjët.

UNË: A del shpesh në qytet?

AI: Nganjëherë, kryesisht ditën e pazarit.

UNË: Me kë je takuar dje në qytet?

AI: Nuk isha dje në qytet, por pardje, ditën e pazarit.

UNË: A të kujtohet me kë krejt je takuar pardje në qytet?

AI: Jam takuar me Ademin, me Azemin, me Qerimin, me Ethemin, me Ridvanin, me Kapllanin, me Selmanin, me Kimeten, me Sadeten, me Safeten, me... me... me...!

UNË: Hajgare po bën ti me mua, a?

AI: Jo, nuk po bëj hajgare, por po ua them emrat e atyre me të cilët e të cilat jam takuar.

UNË: Pse s'po ua thua edhe mbiemrat.

AI: Kot do t'ua thosha, sepse ti nuk i njeh ata.

UNË: A je takuar me Damianin?

AI: Me cilin Damian? Janë disa Damiana në këto katundet ku jetojnë serbë, ku jetojnë shqiptarë e ku jetojnë serbë e shqiptarë.

UNË: Me atë Damianin e bëshëm, të madh, të plotë, të gjatë, që shihet shpesh me pushkë gjahu.

AI: Nuk jam takuar pardje me asnjë Damian: as të gjatë, as të shkurtër, as të hollë e as të trashë.

UNË: Po, kur je takuar me të?

AI: E di edhe ti!

UNË: A takohesh shpesh me Damianin?

AI: Jo më shpesh se ti dikur. Nuk ka shumë rrugë mes katundeve dhe njerëzit takohen deshën s'deshën në ato rrugë.

UNË: Kur je takuar herën e fundit me Damianin?

AI: Nuk më kujtohet saktë dita! Ndoshta para dy javësh?

UNË: Ku je takuar me të?

AI: Në oborrin e shkollës ku mësojnë fëmijët e mi dhe fëmijët e tij.

UNË: Ndonjë ditë tjetër a mos je takuar diku tjetër me Damianin?

AI: Ndoshta në rrugë duke shkuar në vetëshërbimin në dalje të qytetit.

UNË: Je ndalë më gjatë në bisedë me të?

AI: Gjatë? Sa gjatë zgjasin pyetjet e përgjigjet: Si je? Si e ke familjen? A po mësojnë fëmijët?

UNË: Aq?

AI: Aq!

UNË: Atje ku shihesh shpesh ti, në Kodrën e Madhe, a je takuar ndonjë ditë me Damianin?

AI: Jo.

UNË: Hajdari thotë se ju ka parë të dyve, ty e Damianin, ulur afër njëri-tjetrit duke pirë duhan dhe, natyrisht, duke biseduar, me zë të ulët!

AI: Hajdari di edhe të rrejë.

UNË: E ti, a di të rresh?

AI: Jo më shumë se ti!

UNË: E me kushëririn e Damianit, arsimtarin e kimisë, a shihesh ndonjëherë?

AI: Më takon rruga ndonjëherë me të si dikur me ty.

UNË: A të ka pyetur ndonjëherë Damiani për UÇK-në?

AI: Po, më ka pyetur.

UNË: A të ka pyetur ku jam unë që s'po shihem?

AI: Po më ka pyetur.

UNË: A i ke thënë se ku jam.

AI: A frikohesh nëse njerëzit e dinë se ku je, a?

UNË: A frikësohesh ti që s'je ku jam unë, a?

AI: Dole ku deshe. Mos mendo se i tutem asaj patllakes që e ke pas bythe!

UNË: Ti duhet të tutesh prej vetvetes.

AI: E kreu bisedën me ty.

UNË: Por nuk e ke kryer me vetveten!

AI: As ti!

UNË: Do ta shohim kush e kreu e kush s'e kreu fjalën me vetveten. E me Kosovën?

Në fund nuk do të më kujtohen fjalët e armiqve sa heshtja e miqve.

*Martin Luter King*

Nuk do të mund të të hipë askush në shpinë në qoftë se nuk përkulesh.

*Martin Luter King*

Në shpinën e kërrusur hip kushdo.

*Popullore shqiptare*

## **DIALOGU 4: PO TË BIEN SENDET PREJ DUARVE**

**BARDHI**

A ke vërejtur se po të bien sendet prej duarve?

**HAVAJA**

Gjithkujt ndodh t'i bie ndonjë sendet prej duarve.

**BARDHI**

Po, po, ndodh edhe mua të më bjerë ndonjë send prej dorës, por jo shpesh, jo, jo çdo ditë. Dhe, jo çdo send.

**HAVAJA**

E çka s'të bie ty prej dorës?

**BARDHI**

Nuk ndodh të më bjerë prej dorës gota me ujë, me qumësht apo pjata me sarma! E sidomos alltia!

**HAVAJA**

E çka megjithatë ndodh të të bjerë prej dorës ty?

**BARDHI**

Ndodh të me bjerë prej dorës shtatorja e vogël plastike e Haile Selasit.

**HAVAJA**

Javën e kaluar të ka rënë prej dorës gota e çajit! E nxehtë.

Dhe, për pak të është përvëluar prehri! Bash prehri!

**BARDHI**

Nuk më ka rënë prej dorës, por papritmas e kam shtyrë prej tryezës me gishtin e dorës së majtë, me të cilën



desha të marr, në anën tjetër të saj, fletoren e shënimeve e përkthimeve. Dhe, nuk qe e nxehtë, por gati e ftohtë.

HAVAJA

E teshat e mia a s'të kanë rënë prej duarve asnjëherë, a?

BARDHI

Kurrë!

HAVAJA

E mua çka më ka rënë prej dorës?

BARDHI

Njëherë të ka rënë tabakaja në të cilën ende nuk i kishe vënë gotat e çajit.

HAVAJA

Ndonjëherë kjo u ndodh të gjitha grave.

BARDHI

Dje të ra pjata prej duarve.

HAVAJA

Po, më ra prej duarve dhe u bëra shumë nervoze pse më ra!

BARDHI

Sot të ra prej duarve pasqyra dhe nuk u thye pse të ra në prehër. E prehri yt është i butë, gjithmonë ishte i butë.

HAVAJA

Nuk paske harruar se është i butë prehri im.

BARDHI

Nuk e kam harruar dhe s'do ta harroj kurrë atë prehër të butë.

HAVAJA

Nuk do ta harrosh?

BARDHI

Jo, jo, nuk do ta harroj. E dua shumë atë prehër, e kam dashur gjithmonë. Shumë e shumë herë e kam vënë dhe do ta vë kokën në atë prehër.

HAVAJA

Sa shumë më pëlqejnë këto fjalë.

BARDHI

Për shkak se e dua aq shumë atë prehër shqetësohem kur shoh se të bien sendet prej duarve: as gotat, as pjatat, as fletoret, as lapsat nuk dua t'i shoh në atë prehër, sepse dëshiroj në të të bjerë vetëm koka ime!

HAVAJA

Atë kokë dëshiroj ta mbaj në prehër derisa të jem gjallë.

BARDHI

E gjallë do të jesh edhe shumë e shumë vjet, më shumë se unë.

HAVAJA

Nuk dihet se cili do të jetojë më gjatë: ti apo unë, por unë dëshiroj që ti të jetosh më gjatë.

BARDHI

Ti dëshiron që unë të jetoj më gjatë se ti, por unë dëshiroj që ti të jetosh më gjatë se unë.

HAVAJA

Mos e thëntë Zoti.

BARDHI

E thashë dhe ashtu u bëftë.

HAVAJA

Pse? Pse po dëshiruake që unë të jetoj më gjatë se ti?

BARDHI

Për shumë arsye.

HAVAJA

Thuamini, thuamini!

BARDHI

Ti do të jesh një plakë e jashtëzakonshme, e shëndoshë, e dukshme, madje e bukur. Po vërej se vitet po e rrisin dinjitetin e pamjes sate, zojëllëkun tënd.

Kam dëshirë që ti të jetosh më gjatë se unë, sepse ti do të mund t'i bësh hyzmet vetes si deri tani, kurse unë nuk do të isha në gjendje të kujdesesha për veten as edhe një ditë. Kam dëshirë që ti të jetosh më gjatë se unë edhe për arsye se ti do të kujdeseshe më mirë se unë për Anilën dhe

Likun. Apo jo?

Kam dëshirë që ti të jetosh më gjatë se unë edhe për arsyen se ti do të kujdeseshe shumë për varrin tim.

HAVAJA

E ti nuk do të kujdeseshe për fatin tim, a? As për varrin tim, a?

BARDHI

Do të kujdesesha, do të kujdesesha, por nuk do të kisha kohë që ta mbuloja varrin tënd aq shpesh me lule sa ti timin.

HAVAJA

A nuk frikësohesh se edhe lulet do të më binin prej duarve para se t'i vija në varr siç po më bien tani gotat e pjatat?

BARDHI

Nuk frikësohem, ti i do lulet shumë, gjithmonë i ke dashur, kurrë s'të kanë rënë prej duarve.

HAVAJA

A ka edhe ndonjë arsye tjetër pse dëshiron që unë të jetoj më gjatë se ti?

BARDHI

Ka, ka. Dhe një arsye. Derisa ti do të jesh një plakë e bukur, zemërmadhe, e qetë, unë kam drojë se do të bëhem plak i keq me pamjen dhe me sjelljet.

HAVAJA

Por, do të bëheshe plak plot mend.

BARDHI

Çka të duhen mendtë në pleqëri? E në këtë shokëri!

Shokëri!

HAVAJA

Mendtë i duhen shumë pleqërisë, ato s'bien prej kokës si  
sendet prej duarve!

BARDHI

Bien, bien, t'i qesin të tjerët prej kokës.

HAVAJA

Ruanani Zot mendtë e kresë!

BARDHI

Në varr më parë se çdo pjesë tjetër e trupit të njeriut  
asgjësohen trutë.

HAVAJA

Ashtu, a?

BARDHI

Ashtu thonë, thonë... thonë, po dridhet toka, po bëhet  
tërmet!

HAVAJA

Jo, jo, nuk po dridhet toka, po ty po të duket! Kush thotë  
ashtu për trurin? Arkivistët?

BARDHI

Arkeologët!

HAVAJA

Uh! Arkeologët!

BARDHI

Ata rrejnë shumë dhe të tjerët shpesh u besojnë të gjitha  
rrenave të tyre!

## **MBYLLE GOJËN SA S'TA KANË MBYLLUR!**

Jam mbledhur galuc në këtë zyrë! Në zyrën e arkivit.

Mendjen e kam te Havaja. Te këmba e saj e djathtë që po e ngre zharg dhe te duart e saj prej të cilave aq lehtë po i bien sendet, madje edhe çanta!

Më sjell në vete Filipi, Filip Suma, drejtori.

Erdha të të shoh, një dakikë, e të të pyes si po e ndien veten këtu, në këtë zyrë të vogël?

Mirë, mirë.

Të ishte më e madhe do të ishte më mirë, ti je arkivist përkthyes e të duhen shumë libra. Është biblioteka afër, në katin e parë dhe mund shkosh për libra aty kur të duash.

Mirë, mirë, e përsëris përgjigjen.

Do të kemi një manifestim, këtu, këto ditë dhe ma kanë dërguar një tekst që duhet ta përkthesh më shpejt. Nuk është dokument arkivor, por fjalim e ndonjëherë do të detyrohemi t'u përkthejmë edhe fjalime disa figurave, disa personaliteteve. Apo jo? Dhe, disa kolegëve si këtë tekst tani. Apo jo?

Mirë, mirë, e përkthej. Kur duhet të jetë gati?

Sa më shpejt, ndoshta pasnesër.

Paska kohë.

Por, ne këtu, në arkiv, atyre lart s'duhet t'u bëjmë vetëm përkthime herë nga gjuhë të tjera në shqipe e herë nga shqipja në ato gjuhë. Kupton çka, besoj, çka tjetër duhet t'u bëjmë atyre pos përkthimeve.

E çka duhet tjetër të bëjmë për ta?

Duhet t'ua shkruajmë ndonjëherë edhe fjalimet, përshëndetjet, ngushëllimet, urimet, memorandumet, rezolutat...!

Aspak nuk kuptoj pse i kanë bërë kaq të vogla zyrat në të cilat njeriu duhet të jetë shtatë-tetë orë në ditë, në ditë e në natë! E ndërroj temën.

Tavani i ulët e bën edhe më të papërshtatshme, më të papërshtatshme për trupin, për sytë dhe për mendjen këtë zyrë kaq të vogël, të vogël, u kam thënë atyre lart; po kot.

Mjerisht të gjitha zyrat e kësaj ndërtese prej 4337 metrash katrorë në të cilën është Arkivi Shtetëror, më i rëndësishmi që kemi, janë kështu të vogla.

Edhe juaja, a?

Jo, jo, zyra ime, nuk duhet të quhet zyrë po kabinet, kabineti im është i madh, përgjigjet i lumtur drejtori.

Arkitekti që e ka bërë planin e kësaj ndërtese ka kryer fakultetin këtu, në universitetin tonë, apo diku tjetër, në ndonjë shtet tjetër? Kudo ta ketë kryer ai sikur e ka banalizuar profesionin e tij duke bërë këso zyrash si kotece të derrave!

Derrat janë shtazë shumë të zgjuara, më përgjigjet turr drejtori, prandaj s'mund ta krahasoni me të atë arkitekt.

Tryezat e punës, të gjitha tryezat e punës nëpër zyra, janë si e sa kjo e jotja: një metër e gjashtëdhjetë centimetra të gjata dhe një metër e tridhjetë centimetra të gjera. Në to mund të vihen kompjuteri, një fletore e vogël, një kimik dhe shuplakat e dy duarve pa gjë në to!

Mrekulli!

E karriget? Apo e shihni karrigen time si është? Kur ulesh në të e kur çohesh të përkëdhel veshët me ato rrak-